



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:145637

Datë: 06.12.2022

Numri i dokumentit: 03719200

C.nr.1357/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtoreshen profesionale S.F. në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.H. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari avokat V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit Prizren, për shkak të kompenzimit të pagës jubilarë, vlera e kontestit 221,00 euro, pas dhënies së përgjigjes në padi, me datë 22.11.2022, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.H. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj paditëses shumë prej 221,00 euro, me kamatë prej 8 %, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë (06.07.2021) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura që t'ia paguajë paditëses shpenzimet procedurale në shumë prej 124,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja M.H. nga Prizreni, përmes të autorizurit të saj avokat V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 221,00 euro.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më datën 15.11.2022 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesë padinë me arsyetim të mungesës së mjeteve buxhetore ngase Ministria e Financave nuk ka ndarë mjete buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve.

Paditësja padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: kontratën e punës nr. prot. 241, vërtetimin nr.200 datës 02.07.2021 e lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Ymer Prizreni" në Prizren, me të cilin vërtetohet përvoja e punës për paditësen dhe listën e pagave.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura Shkolla e Mesme Profesionale "Ymer Prizreni" në Prizren, por mbetet kontestues fakti se paditëses a i takon shpërblimi jubilar për mbi 10 vite pune, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditëses është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit 013 nr.2056 datës 18.04.2017 konkretisht të nenit 35 par.8 i cili rregullon çështjes e pagesës së pagave jubilarë.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjësë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditëses, ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumën në lartësi prej 221,00 €.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (06.07.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.265/2020 të dates 02.01.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104.00 euro dhe në emër të taksës për padi 20.00 euro bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1357/21 me datë 22.11.2022

B. profesionale
Sadeta Fazlji

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.